

LISTA E SHËRBIMEVE PËR PUBLIKUN

Zyra e Gjendjes Civile pranë Prefektit të Qarkut Tiranë ofron këto shërbime për banorët e Qarkut Tiranë:

- Çertifikata nga akti i lindjes, martesës dhe akti i vdekjes që nga viti 1924,
- Çertifikata të trunqeve familjare për vitet 1930-1945, 1945-1950, 1950-1974,
- Shërbimi ofrohet kundrejt pagesës së miratuar me akt ligjor,
- Shërbimi ofrohet në sportelin e Zyrës së Gjendjes Civile.

Prefekti i Qarkut Tiranë ofron këtë shërbim:

- Legalizim i çertifikatave, vërtetimeve apo akteve të njësive të pushtetit vendor të Qarkut Tiranë me qëllim përdorimin e dokumentit jashtë shtetit. Dokumenti duhet legalizuar fillimisht pranë Prefektit të Qarkut Tiranë. Më pas dërgohet sipas rastit për vulë Apostille në Ministrinë e Jashtme për shtetet që kanë nënshkruar Konventën e Hagës (5 tetor 1961) “Mbi heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumentave zyrtare të huaj”. Për shtetet që nuk e kanë nënshkruar Konventën e Hagës, pas legalizimit nga Prefekti i Qarkut Tiranë, duhet të bëhet legalizimi i këtyre dokumentave në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës. Për më shumë informacion drejtohuni në faqen e Ministrisë për Evropën dhe Punëve të Jashtme <https://punetejashtme.gov.al/legalizimi-dhe-apostilimi-i-dokumente/>,
- Shërbimi ofrohet vetëm përmes Postës Shqiptare. Shërbimi ofrohet pa pagesë nga Prefekti i Qarkut Tiranë. Qytetari paguan vetëm shërbimin postar.

Në rast ankese lidhur me shërbimet e ofruara, ju lutemi të kontaktoni në adresën zyrtare të e-mailit: prefekti@prefektitirane.gov.al.